

Libra nga Paulo Coelho,
prej Shtëpisë Botuese TOENA

Alkimisti

Mali i pestë

Veronika vendos të vdesë

Djalli dhe zonjusha Prym

Pelegri i Kompostelës

Manuali i luftëtarit të dritës

Njëmbëdhjetë minuta

Zahiri

Shtriga e Portobelos

Buzë lumit Piedra u ula dhe qava

Fitimtari është i vetëm

Brida

Alef

Shkelja e kurorës

Dorëshkrimi i gjetur në Akra

Spiunia

Hipi

Shigjetari

PAULO COELHO
SHIGJETARI

BOTIMET TOENA

PAULO COELHO

SHIGJETARI

Përktheu nga anglishtja Platon Pulla
Ilustroi Mirjana Madhi

BOTIMET TOENA
Tiranë

Titulli në original: *O caminho do arco*

Ky libër u botua sipas marrëveshjes me Sant Jordi
Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona - Spain

www.santjordi-asociados.com

Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Diana Çuli

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-376-52-7

© Paulo Coelho, 2003

<http://paulocoelhoblog.com>

© në shqip Botimet Toena

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

E-mail: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

*Kushtuar Leonardo Oiticica-s,
i cili, një mëngjes, kur më pa duke praktikuar
kyudo-n në Saint-Martin
më dha idenë për këtë libër.*

*Oh, Marie e ngjizur pa mëkatuar,
lutu për ne që përgjërohemi për Ty!
Amin!*


*Një lutje e pashoqëruar me veprim
është një shigjetë pa hark.*

*Një veprim i pashoqëruar me lutje
është një hark pa shigjetë.*

Ella Wheeler Wilcox

Përmbajtja

Hyrje	19
Aleatë	33
Harku	47
Shigjeta	53
Objektivi	57
Pozicioni i trupit	67
Si të mbash shigjetën	75
Si të mbash harkun	83
Si të tendosësh kordën e harkut	89
Si ta vëzhgosh objektivin	97
Çasti i lëshimit	105
Përsëritje	113
Si të ndjekësh flurudhën e shigjetës	123
Shigjetari pa hark, pa shigjetë, pa objektiv	133
Epilog	141
Falënderime	149
Shënime për shkrimtarin	151
Shënime për ilustruesen	152





HYRJE



Tetsuja.

Djaloshi, i habitur, vështroi të huajin.

- Askush në këtë qytet nuk e ka parë ndonjëherë Tetsujën të mbajë hark, - u përgjigj ai. - Të gjithë këtu e njohin si marangoz.

- Ndoshta ka hequr dorë, ndoshta s'ka më guxim, por kjo nuk më intereson, - këmbënguli i huaji. - Por nuk mund të konsiderohet si shigjetari më i mirë në vend, nëse e ka braktisur profesionin e tij. Kjo është arsyeja përse kam kaq ditë që udhëtoj, për ta sfiduar dhe për t'i dhënë fund famës që nuk e meriton më.

Djaloshi e kuptoi se nuk kishte kuptim të kundërshtonte. Më mirë do të ishte ta çonte burrin në zdrukthëtar, në mënyrë që ai ta shihte me sytë e tij se e kishte gabim.

Tetsuja ishte te punishtja që ndodhej në pjesën e pasme të shtëpisë. Ai u kthye të shihte kush kishte hyrë, por buzëqeshja i ngriu në buzë kur sytë i shkuan te çanta e madhe që mbante i huaji.

- Është pikërisht ajo që ti mendon se është, - tha i porsaardhuri. - Nuk jam këtu për të poshtëruar apo provokuar njeriun që është bërë legjendë. Dua thjesht të tregoj se, pas kaq vitesh stërvitjeje, ia kam dalë të arrij përsosmërinë.

Tetsuja bëri sikur po rifillonte punën që kishte në dorë: po i vendoste këmbët një tavoline.

- Një njeri i shndërruar në model për një brez të tërë nuk mund të zhduket aq lehtë si bëre ti, - vazhdoi i huaji. - Ndoqa mësimet e tua, u përpoqa të respektoj rrugëtimin e harkut dhe e meritoj të më ndjekësh teksa gjuaj. Nëse e bën këtë, do të iki dhe nuk do t'i them kurrë askujt se ku ta gjejnë më të mirin ndër të gjithë mjeshtrit.

I huaji nxori nga çanta një hark të gjatë prej bambuje të lyer me llak, me dorezën pak më poshtë qendrës. U përkul në drejtim të Tetsujës, doli në kopsht dhe u përkul përsëri drejt një vendi të caktuar. Në vazhdim nxori një shigjetë të zbukuruar me pendë shqiponje, qëndroi me këmbët të mbështetura fort në tokë, që të kishte një bazë të qëndrueshme për gjuajtje, dhe me një rën dorë e afroi harkun para fytyrës, ndërsa me tjetrën vendosi shigjetën.

Djaloshi po e ndiqte me sy ku dallohej gëzimi përzier me habi. Tetsuja tashmë e kishte lënë punën dhe vështronte të huajin me njëfarë kureshtjeje.

Me shigjetën të fiksuar te korda, i huaji e lëvizi harkun në mënyrë që të ishte në një drejtim me mesin e kraharorit. E ngriti mbi kokë dhe, teksa i ulte me ngadalë duart, filloi të tërheqë kordën mbrapsht.

Kur shigjeta arriti në të njëjtin nivel me fytyrën e tij, harku u tendos plotësisht. Për një çast, që u duk sa një shekull, harku dhe shigjetari qëndruan krejtësisht pa lëvizur. Djaloshi shikonte andej nga ishte drejtuar shigjeta, por nuk mund të dallonte asgjë.

Papritur, gishtërinjtë që mbanin kordën u hapën, dora u shty pas, harku në dorën tjetër mori një trajtë të hijshme dhe shigjeta u zhduk nga fusha e pamjes për t'u rishfaqur më larg.

- Shko merre, - i tha Tetsuja.

Djaloshi u kthye me shigjetën në dorë: ajo kishte shpuar një qershi, të cilën e gjeti në tokë, dyzet metra larg.

Tetsuja u përkul drejt shigjetarit, vajti në një cep të punishtes dhe mori diçka që ngjante me një copë të hollë druri paksa të rrumbullakosur dhe të mbështjellë me një rrip të gjatë e të ngushtë prej lëkure. E shpëstolli me ngadalë dhe u shfaq një hark i ngjashëm me atë të të huajit, përveçse dukej të ishte shumë më i përdorur.

- Nuk kam shigjeta, kështu që do të duhet të përdor një prej shigjetave të tua. Do të bëj çfarëdo të më

kërkosh, por ti, do të duhet të mbash premtimin që bëre, të mos e tregosh kurrë emrin e fshatit ku unë jetoj. Nëse të pyet dikush për mua, thuaji që shkove deri në fund të botës për të më gjetur, por aty more vesh se më kishte pickuar gjarpri dhe se kisha vdekur pas dy ditësh.

I huaji pohoi me kokë dhe i dha një prej shigjetave të tij.

Tetsuja e mbështeti njërin skaj të harkut prej bambuje pas murit, e ngjeshi fort dhe kaloi kordën te harku. Pastaj, pa thënë asnjë fjalë, u nis drejt maleve.

I huaji dhe djaloshi shkuan me të. Ecën pothuajse një orë, derisa arritën te një grykë e madhe midis dy masiveve shkëmbore, mes të cilave rridhte një lumë i rrëmbyeshëm, që mund ta kaloje vetëm nëpërmjet një ure të brishtë prej litarësh shumë të përdorur, gati për t'u këputur.

Mjaft i qetë, Tetsuja eci deri në mes të urës, lëkundja e të cilës nuk ishte ogur i mirë. Ai u përkul për të parë diçka në bregun tjetër, vuri shigjetën te harku ashtu si kishte bërë edhe i huaji, e ngriti lart, tërhoqi shigjetën mbrapa në nivelin e fytyrës dhe gjuajti.

Djaloshi dhe i huaji panë një pjeshkë të pjekur, pothuajse njëzet metra larg, të shpuar nga shigjeta.

- Ti shpove një qershi, ndërsa unë një pjeshkë, - tha Tetsuja, duke u kthyer në breg, ku ndihej i sigurt.
- Qershia është më e vogël. E godite objektivin tënd

nga një largësi prej dyzet metrash, ndërsa objektivi im ishte në një distancë sa gjysma e tëndes. Rrjedhimisht duhet të jesh i aftë të përsërisësh atë që sapo bëra unë. Qëndro aty në mes të urës dhe bëj atë që bëra unë.

I tmerruar, i huaji eci deri në mes të urës gjysmë të shkatërruar, shumë i frikësuar nga ideja e boshllëkut nën këmbët e tij. Bëri të njëjtin ritual lëvizjesh dhe gjuajti në drejtim të pemës me pjeshkë, por shigjeta kaloi anash.

Kur u kthye në breg ishte i zbehtë si një i vdekur.

- Je i patrembur dhe imponues, dhe e mban trupin në pozicionin e duhur, - tha Tetsuja. - E njeh mirë teknikën dhe je bërë zot i harkut, por nuk je bërë zot i mendjes sate. Di si të gjuash në shenjë kur të gjitha kushtet janë të favorshme, por, nëse je në terren të vështirë, nuk e godet dot objektivin. Shigjetari nuk mund ta zgjedhë gjithmonë fushën e betejës, kështu që fillo përsëri të stërvitesh dhe përgatitu për situata të pafavorshme. Vazhdoje rrugën e harkut se është rrugëtimi i një jete, por mbaje mend se një gjuajtje e mirë dhe në shenjë është shumë më e ndryshme nga gjuajtja që realizohet në kushtet e qetësisë shpirtërore.

I huaji bëri edhe një përkulje të thellë, vendosi harkun dhe shigjetën në çantën e gjatë që mbante në sup dhe u largua.

Gjatë rrugës së kthimit djaloshi ishte i gëzuar.

- I tregove vendin, Tetsuja! Je, vërtet, më i miri!





Kurrë nuk duhet t'i gjykojmë njerëzit nëse më parë nuk jemi mësuar t'i dëgjojmë dhe t'i respektojmë ata. I huaji ishte njeri i mirë; ai nuk më poshtëroi dhe nuk u përpoq të tregonte se është më i mirë se unë, edhe nëse ndoshta dha këtë përshtypje. Donte të tregonte mjeshtërinë e tij dhe të njihej si i tillë, edhe pse u duk sikur donte të më sfidonte. Përveç kësaj, përballja me pengesa të papritura është pjesë e rrugës së harkut dhe kjo ishte pikërisht ajo që i huaji më lejoi të bëja sot.

- Ai tha se ti ishe më i miri dhe unë as që e dija se ti ishe mjeshtër i harkut. Atëherë, pse punon si marangoz?

- Sepse rruga e harkut shërben për gjithçka, dhe ëndrra ime ishte të punoja drurin. Përveç kësaj, një harkëtar i që ndjek shtegun nuk i nevojitet një hark, një shigjetë apo një objektiv.

- Asgjë interesante nuk ndodh kurrë në këtë fshat dhe tani krejt papritur gjendem këtu, ballë përballë me mësuesin e një mjeshtërie për të cilën tashmë

nuk interesohet askush, - tha djaloshi me sytë që i shkëlqenin. - Cila është rruga e harkut? Mund të ma mësosh?

- Nuk është e vështirë për të ta mësuar. Ta mësoj edhe për një orë, rrugës teksa kthehem për në fshat. E vështirë është të stërvitesh çdo ditë, derisa të arrish saktësinë e duhur.

Sytë e djaloshit ngjanin sikur luteshin për të thënë po. Tetsuja eci i heshtur për pothuajse pesëmbëdhjetë minuta dhe kur foli përsëri zëri i tij tingëlloi më rinor.

- Sot jam i kënaqur. Respektova njeriun që më shpëtoi jetën para shumë vitesh, prandaj do të të mësoj të gjitha rregullat e domosdoshme, por nuk mund të bëj asgjë më tepër se kaq. Nëse i kupton ato që do të të them, mund t'i përdorësh mësimet e mia si të duash. Pra, pak më parë më quajte mjeshtër. Çfarë është një mjeshtër? Jo vetëm dikush që të mëson diçka, por më tepër ai që e frymëzon nxënësin të bëjë më të mirën që mundet për të zbuluar njohuri që tashmë i ka në shpirt.

Dhe, teksa zbrisnin nga mali, Tetsuja i shpjegoi rrugëtimin e harkut.

